



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Kryesia e Kuvendit
P-013
Prishtinë, më 1 prill 2008, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT ME KRYETARËT E GRUPEVE
PARLAMENTARE, TË MBAJTUR MË 1 PRILL 2008**

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit dhe anëtarët e Kryesisë: Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Ibrahim Gashi, Nexhat Daci, Naim Maloku, Sllobodan Petroviq dhe Eqrem Kryeziu, kurse mungoi Xhezair Murati.

Nga grupet parlamentare: Ramë Buja, Lulzim Zeneli, Ardian Gjini, Bojan Stojanoviq, Ibrahim Makolli dhe Zylfi Merxha.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Thëllënza Arifi dhe Shefqet Rexhepi;

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi;

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit të Kosovës.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Kryesia, me propozimin e Kryetarit, miratoi këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë të mbajtura më 20 dhe 25 marsit 2008,
2. Propozimi i rendi i ditës për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i Propozimit të Qeverisë për shpalljen e hapësirës – trasesë për ndërtimin e Autoudhës Morinë – Merdare dhe Prishtinë - Hani i Elezit, si zonë me interes të veçantë në Kosovë,
4. Ndarja e përgjegjësi të anëtarëve të Kryesisë, sipas Rregullores së Punës së Kryesisë,
5. Shqyrtimi i Projektregullores së Punës së komisioneve parlamentare,
6. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për të Drejta e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione për blerjen e shtypit ditor për kryetarët e komisioneve parlamentare,
7. Shqyrtimi i kërkesës së deputetit Sadik Idriz për kompensimin e shpenzimeve për pjesëmarrje në Konferencën Ndërkombëtare, në Slloveni.
8. Të ndryshme:
 - 8.1 Njoftimi me vendimin e Grupit Parlamentar të LDK – së për ndërrimin e kryetarit të Grupit.

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë të mbajtura më 20 e 25 mars 2008

Procesverbalet e mbledhjeve të Kryesisë së Kuvendit, të mbajtura më 20 e 25 mars 2008 u miratuan pa vërejtje.

2. Propozimi i rendit të ditës për seancën e ardhshme plenare

Kryetari i informoi anëtarët e Kryesisë dhe kryetarët e grupeve parlamentare me materialet e përgatitura për seancën e radhës. Ai kërkoi pëlqimin e tyre për secilën pikë të rendit të ditës, veç e veç.

Kryesia, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca e radhës të mbahet më 4 prill 2008, në orën 10:00, me këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për vula në institucionet e Republikës së Kosovës,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Sigurinë private,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, dhe
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kooperativat e bujqve.

Në vazhdim, Kryesia i zhvilloi punimet pa praninë e kryetarëve të grupeve parlamentare.

3. Shqyrtimi i Propozimvendimit të Qeverisë për shpalljen e hapësirës – trasesë si zonë me interes të veçantë publik për ndërtimin e Autoudhës Morinë – Merdare dhe Prishtinë - Hani i Elezit

Kryesia, pasi shqyrtoi Propozimvendimin e Qeverisë, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

1. Ngarkohet Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Miniera, Transport e Telekomunikacion dhe Komisioni për Buxhet e Financa që ta shqyrtojnë Propozimvendimin e Qeverisë për shpalljen e hapësirës-trasese zonë me interes të veçantë publikë në Kosovës për ndërtimin e Autoudhës Morinë-Merdar dhe Prishtinë-Hani i Elezit.
2. Komisionet, sipas paragrafit 1 të këtij përfundimi, duhet t'ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime në kohën sa më të shkurt.

4. Ndarja e përgjegjësisë të anëtarëve të Kryesisë së Kuvendit

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me ndarjen e përgjegjësisë, me propozimit të Kryetarit, mori këtë

V E N D I M

PËR NDARJEN E PËRGJEGJËSIVE TË ANËTARËVE TË KRYESISË SË KUVENDIT

1. Anëtarët e Kryesisë së Kuvendit janë përgjegjës për fushat, si vijon:
 - 1.1 Xhavit Haliti dhe Sabri Hamiti për koordinimin e punëve me komisionet parlamentare, me Qeverinë e Kosovës dhe me Zyrën Evropiane në Kosovë.
 - 1.2 Eqrem Kryeziu dhe Naim Maloku për mbikëqyrjen dhe menaxhimin e stafit të Kuvendit dhe mbikëqyrjen e menaxhimin e sigurisë së ndërtesës së Kuvendit.
 - 1.3 Ibrahim Gashi dhe Xhezair Murati për mbikëqyrjen e menaxhimit dhe të ekzekutimit të Buxhetit të Kuvendit.
 - 1.4 Nexhat Daci dhe Slobodan Petroviq për shqyrtimin e kërkesave të deputetëve dhe të organeve të tjera të Kuvendit drejtuar Kryesisë dhe për editimin e Buletinit të Kuvendit.

5. Shqyrtimi i Projektregulloreve së punës së komisioneve parlamentare

Kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë me Projektregulloren e punës së komisioneve parlamentare, të hartuar nga Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, i ndihmuar nga Instituti Kombëtar Demokratik (NDI), me të cilën rregullohet mënyra e organizimit dhe e funksionimit të komisioneve.

Kryesia, pas diskutoi lidhur me këtë projektregullore, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

1. Kërkohet nga Komisioni për Buxhet e Financa që ta shqyrtojë Projektregulloren e Punës së komisioneve parlamentare dhe Kryesisë t'ia paraqesë rekomandimin lidhur me implikimet buxhetore të saj.
 2. Rekomandimi nga paragrafi 1 të paraqitet në afatin sa më të shkurtë.
- 6. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për të Drejta e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione për blerjen e shtypit ditor për kryetarët e komisioneve parlamentare**

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e Komisionit, mori këtë

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur e Peticione për blerjen e shtypit ditor për të gjitha komisionet parlamentare.
 2. Shpenzimet për blerjen e shtypit, nga paragrafi 1 i këtij vendimi, i përballon Buxheti i Kuvendit.
 3. Ngarkohet Administrata e Kuvendit ta zbatojë këtë vendim.
- 7. Shqyrtimi i kërkesës së deputetit Sadik Idriz për kompensimin e shpenzimeve për pjesëmarrje në Konferencën Ndërkombëtare, në Slloveni**

Kryesia konstatoi se kërkesa e deputetit Sadik Idriz nuk është në pajtim me Vendimin e Kryesisë nr. 02-2242-1/06, për shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit.

8. Të ndryshme

8.1 Njoftimi me vendimin e Grupit Parlamentar të LDK – së për ndërrimin e kryetarit të këtij grupi

Kryesia u njoftua me vendimin e Grupit Parlamentarë të LDK-së, me të cilin kryetar i këtij grupi ishte caktuar deputeti **Lutfi Haziri**, në vend të kryetarit të deritanishëm, Eqrem Kryeziu.

8.2 Njoftimi lidhur me vizitën në Norvegji të anëtarëve të Komisionit për Punë të Jashtme

Sabri Hamiti i njoftoi anëtarët e Kryesisë lidhur me vizitën që kishin realizuar ai dhe Xhavit Halitin, në emër të Komisionit për Punë të Jashtme, në Norvegji, prej 27 deri më 31 mars 2008.

Ata gjatë kësaj vizite ishin pritur në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Norvegjisë, ku u ishte premtuar mbështetje e këtij shteti për Kosovën. Ata ishin takuar edhe me Komunitetin shqiptar, që jeton në Norvegji, dhe u informuan për organizimin, aktivitetet e këtij komuniteti në mbështetje për Kosovën.

Kryetari e deklaroi mbledhjen të mbyllur në orën 12:10 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

E hartoi:

Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale